



REPUBLICA E KOSOVES - VLADA E KOSOVES	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE	
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARCHIVE, ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org Org Unit	3
Nr. Prot. Prot. No.	632
Nr i faqeve Br stranica No pages	2
Datum Date	30.05.2022
Prishtinë / g	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstva  
Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije - Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation**

Prishtinë, më 30 maj 2022  
Ref.nr: 3/632

Komisioni i MASHTI për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të IPAAP, në bazë të dispozitave të nenit 46 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në mbështetje të Udhëzimit administrativ nr. 17/2016 - Kriteret për licencimin dhe rilicencimin e institucioneve arsimore private parauniversitar, të mesëm të lartë profesional dhe institucioneve aftësuese profesionale si dhe kërkesës së institucionit "Gjimnazi Britanik për Teknologji" në Prishtinë, nr. 631 dt. 30.03.2022, nxjerr :

**VENDIM**

1. LICENCOHET institucioni arsimor dhe aftësues profesional "Gjimnazi Britanik për Teknologji" në Prishtinë, rr. "Dervish Qollaku", për ushtrimin e veprimtarisë arsimore dhe aftësuese profesionale për nivelin IV (katër) sipas KKK për programin:

**1.1. "Teknologji e Informacionit"**

2. Institucioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, licencohet për periudhën 31.05.2022 deri me dt.31.08.2025.
3. Veprimtaria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi ushtrohet në përputhje me certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe legjislacioni në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Në bazë të dispozitave të lartcekura, Komisioni i veçantë i MASHT-it, shqyrtoi kërkesën për licencim nr. 631 dt. 30.03.2022.

Komisioni në përputhje me legjislacionin në fuqi administroi dokumentacionin e ofruar, zhvilloi procedurat administrative, vizitoj institucionin dhe në bazë të Raportit të këtij

komisioni të datës 10 maj 2022, konstatoi se, IAAP “Gjimnazi Britanik për Teknologji” në Prishtinë, i ka plotësuar kushtet dhe kriteret bazë për zhvillimin dhe ofrimin e veprimtarisë për arsim profesional të nivelit të IV ( katër) në programin e lartcekura, të përcaktuara me Udhëzim administrativ nr. 17/2016, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Afati i kohëzgjatjes së licencës është 3 (tre) vite, në përputhje me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).**

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në afat brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- IAP “Gjimnazi Britanik për Teknologji” në Prishtinë;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm;
- Inspektoratit të Arsimit në MASHTI;
- Divizionit për sigurim të cilësisë, standarde, vlerësim dhe licencim;
- Arkivit të MASHTI.

Valbona Feti-Mjeku, kryesuese e komisionit

